



VENDIM

Nr.14, Datë 19.01.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS SË SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SH.P.K., ME NUMËR. 248, SERIA PV14K, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.94, DATË 06.10.2014, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE “HURDHAS 3”.

Në mbështetje të neneve 16; 20, gërma “b” dhe 43, pika 1 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së Nr. 840, datë 11.06.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; neneve 10 dhe 15 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të Bordit të ERE; nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 01.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licensës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1” me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2” me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3” me fuqi 1,2 MW, për një afat 30 vjeçar, me licencën nr. 248, Seria PV14K, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 94, datë 06.10.2014.
- Me shkresën nr. 791 Prot., datë 11.11.2016, konçensionari “Komp Energji” sh.p.k., ka kërkuar zëvendësimin e emrit të konçensionarit “Komp Energji” sh.p.k., që mban tashmë licencën e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2”, “Hurdhas 3”, me nr. 248, Seria PV14K, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 94, datë

06.10.2014, me emrin e shoqërisë konçesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

- Referuar kërkesës nr. 791 Prot., datë 11.11.2016 të konçesionarit si dhe aplikimit të po kësaj shoqërie për licensim, kërkesa të cilat nuk vijnë në pajtim me njëra- tjetrën dhe frymën e ligjit për konçensionet, tregojnë se veprimet e shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k., në cilësinë e Konçesionarit, për tu licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, janë veprime jo korrekte, të cilat kanë sjellë paqartësi gjatë procedurës të licensimit, për rrjedhojë, del e nevojshme të bëhet modifikimi i licencës në favor të shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me numër 248, Seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 94, datë 06.10.2014, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” të mbajtur nga konçesionari “Komp Energji” sh.p.k. .
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.